73	Gjelosh Dednde	8594	12/97	153.7	8500	1306450	Proces regjistrimi
74	Gjovalin Dednde	8594	12/98	193	8500	1640500	Proces regjistrimi
75	Pllumb Lulashi	8594	12/128	120.4	8500	1023400	Proces regjistrimi

76	Gjon Marashi, Pjeter Gjoni		8594	12/130	151.7	8500	1289450	Proces regjistrimi
77	Pal Zefi		8594	12/171	288.8	8500	2454800	Proces regjistrimi
78	Ndoc Kol Marku		8594	12/176	141	8500	1198500	Proces regjistrimi
79	Gjon Mirashi		8594	12/181	3.5	8500	29750	Proces regjistrimi
80	Zef Deda		8594	12/202	102	8500	867000	Proces regjistrimi
81	Trashegimt. Hile Shllaku		8593	16/192	101	8500	858500	Proces regjistrimi
82	Kel Baçli		8593	16/148	323.5	8500	2749750	Proces regjistrimi
83	Kol Rroku		8593	16/87	32.4	8500	275400	Proces regjistrimi
84	Gjin Dede Krepj		8593	16/203	62.2	8500	528700	Konfirmuar nga ZRPP-ja
85	Alfred Hangjari		8593	16/202	112	8500	952000	Proces regjistrimi
86	Ndue Pjetra		8593	16/231	15.7	8500	133450	Konfirmuar nga ZRPP-ja
87	Gjon Kol Jaku		8593	15/451	13.4	8500	113900	Konfirmuar nga ZRPP-ja
88	Marash Marku		8593	15/91	14.2	8500	120700	Proces regjistrimi
89	Pjeter Marku		8593	15/84	19.6	8500	166600	Proces regjistrimi
90	Nike Zogu		8593	15/50	5.4	8500	45900	Proces regjistrimi
91	Nikolin Marku		8593	15/35	211.8	8500	1800300	Proces regjistrimi
92	Pjeter Ndoja		8593	15/30	18.4	8500	156400	Proces regjistrimi
93	Tonin Gjoka		8593	15/29	18.6	8500	158100	Proces regjistrimi
94	Murgeshat "SUORE PICOLE"		8593	9/287	40	8500	340000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
95	Gjon Peraj		8593	9/286	128	8500	1088000	Proces regjistrimi
96	Mhill Foleta		8593	9/194	26.7	8500	226950	Proces regjistrimi
97	Tom Tollozi		8593	9/193	10	8500	85000	Proces regjistrimi
98	Gege Tollozi		8593	9/192	19.5	8500	165750	Proces regjistrimi
99	Pjeter Guri		8593	9/114	29.6	8500	251600	Proces regjistrimi
100	Ndue Geshtenja		8593	9/112	50	8500	425000	Proces regjistrimi
101	Ndoc Poja		8593	9/109	158	8500	1343000	Proces regjistrimi
102	Mark Xhani		8593	9/25	87.3	8500	742050	Proces regjistrimi
103	Fran Vrina		8593	9/24	12.4	8500	105400	Proces regjistrimi
104	Tonin Beka		8593	9/22	223	8500	1895500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
105	Rrok Luma		8593	10/123	159	8500	1351500	Proces regjistrimi
106	Tonin Beka		8593	10/125	104	8500	884000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
107	Gezim Bega		8593	10/67	15	8500	127500	Proces regjistrimi
108	Alfons Cico		8593	8/31	942.5	8500	8011250	Proces regjistrimi
109	Pjerin Lleshi		8593	8/241	157	8500	1334500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
110	Ernest Gjurarj, Marjan Frashni, Balto D		8593	8/257	81.4	8500	691900	Konfirmuar nga ZRPP-ja
111	Gjon Vat Lajthia		8593	8/205	195.6	8500	1662600	Konfirmuar nga ZRPP-ja
112	Paulin Radovani		8593	8/294	91.3	8500	776050	Konfirmuar nga ZRPP
113	Pal Bregu		8593	8/3	4	8500	34000	Proces regjistrimi
114	Ndue Zeka		8593	8/4	102.8	8500	873800	Proces regjistrimi
115	Mhill Zefi		8593	11/306	37	15000	555000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
116	Zef Pjetri		8593	11/297	82	15000	1230000	Proces regjistrimi
117	Halit Caka		8593	11/268	77	15000	1155000	Proces regjistrimi
118	Fran Mark Kroni		8593	11/269	44	15000	660000	Konfirmuar nga ZRPP-ja

119	Zalvator Kiçi		8593	11/299	74	15000	1110000	Proces regjistrimi
120	Jolanda Boçi		8593	11/313	62	15000	930000	Proces regjistrimi
121	Prend Llesh Kocaj		8593	11/319	68.5	15000	1027500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
122	Hektor Kapaklia		8593	11/320	45	15000	675000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
123	Gjon + Rregjina Kolnikaj		8593	12/12	101	15000	1515000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
124	Nikolla Beroviq		8593	12/71	753	15000	11295000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
125	Trashigim Muzhani		8593	12/82	434.5	15000	6517500	Proces regjistrimi
126	Trashigim Pal Alekaj		8593	13/257	76	8500	646000	Konfirmuar nga ZRPP
127	Trasheg. Pepaj		8593	13/59	154.6	8500	1314100	Proces regjistrimi
128	Gjergj Markaj		8592	9/179	5	15000	75000	Konfirmuar nga ZRPP
129	Trasheg. Lleshaj		8592	10/5	13.3	15000	199500	Konfirmuar nga ZRPP
130	Gjergj Gjoni		8592	10/72	19	15000	285000	Proces regjistrimi
131	Ali Burgaj		8592	12/148	106.3	8500	903550	Proces regjistrimi
132	Isa Kodra		8592	12/149	64	8500	544000	Proces regjistrimi
133	Isa Kodra etj.		8592	12/18	307	8500	2609500	Proces regjistrimi
134	Isa Milla		8592	12/7	384.2	8500	3265700	Proces regjistrimi
135	Fadil Halluni		8592	12/154	62.3	8500	529550	Konfirmuar nga ZRPP-ja
136	Xhevat Halluni		8592	12/155	93.8	8500	797300	Konfirmuar nga ZRPP-ja
137	Hamidie Halluni		8592	12/167	23	8500	195500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
138	Agim Halluni		8592	12/168	18	8500	153000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
139	Vaid Halluni		8592	12/169	52	8500	442000	Proces regjistrimi
140	Bajram Halluni		8592	12/170	38	8500	323000	Proces regjistrimi
141	Dede dhe Gjon Beka		8592	8/73	45.8	15000	687000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
142	Lazer dhe Dede dhe Gjon Beka		8592	8/74	218	15000	3270000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
143	Lazer Beka		8592	8/75	176	15000	2640000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
144	Gjergj&Tonin Nika		8592	8/76	137.8	15000	2067000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
145	Mark Çunxhonaj		8592	8/77	289.2	15000	4338000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
146	Sokol Vistaraj		8592	8/78	78.2	15000	1173000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
147	Xhevahire Mesi		8592	8/1	278.5	15000	4177500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
148	Hajredin Vajushi		8592	8/2	642.2	15000	9633000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
149	Ymer Bala		8592	8/4	24	15000	360000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
150	Ismet Bala		8592	8/50	22.4	15000	336000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
151	Ismet dhe Ymer Bala		8592	8/51	162	15000	2430000	Proces regjistrimi
152	Skender Kraja		8592	8/316	29.3	15000	439500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
153	Shaqir Tyrbetari		8592	8/317	61.7	15000	925500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
154	Rifat Qamil Rexhvelaj		8592	8/319	43.6	15000	654000	Proces regjistrimi
155	Bike Paruni		8592	8/320	59.5	15000	892500	Proces regjistrimi
156	Qemal Viktor Fusha		8592	8/321	102.4	15000	1536000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
157	Fatmir Tusha		8592	8/322	79.3	15000	1189500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
158	Gezim Tusha		8592	8/323	182.7	15000	2740500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
159	Faruk	Halluni	8592	12/157	51.2	8500	435200	Proces regjistrimi
		TOTALI			24875.6		243642950	

VENDIM
Nr.274, datë 6.4.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS QË LIDH
NDËRTESEN E RE TË QENDRËS DISPEÇER DHE ZYRAT E OPERATORIT TË
SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST) SHA, ME NËNSTACIONIN 400 KV, KASHAR,
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës që lidh ndërtesën e re të qendrës dispeçer dhe zyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., me nënstacionin 400 kV, Kashar, Tiranë, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të “OST” sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen prej 8 535 (tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë) m² tokë bujqësore arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 3 993 276 (tre milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 993 276 (tre milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga fondet e “OST” sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën 740 000 (shtatëqind e dyzet mijë) lekë, të përballohet nga “OST” sh.a., si subjekt kërkues i këtij shpronësimi.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit maj 2011 dhe të përfundojë brenda muajit nëntor 2011.

7. Pagesa e të shpronësuarve të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999.

8. Punimet për ndërtimin e rrugës që lidh ndërtesën e re të qendrës dispeçer dhe zyrat të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., me nënstacionin 400 kV, Kashar, Tiranë, të përfundojnë brenda muajit nëntor 2011.

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe “OST” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË RRUGËS QË LIDH QENDRËN DISPECER ME
N/STAC.400 KV “TIRANA 2”**

**Qarku: Tiranë
Komuna: Kashar**

	Lista e pronarëve për shpronësim definitiv (sip. tokë bujqësore)															
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Prona në m ² (totale)	Gjendja juridike nga ZVRPP	Sip. rrugë m ²	Çmimi tokës, lekë/ m2	Vlera në lekë për tokën	Lloji i kulturës	Çmimi i kulturës, lekë/ ha	Vlera në lekë për kulturën	Vlera totale në lekë	Shënime
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1	Mexhit	Mersin	Sula	arë	2105	1/23	2535	pronar	1000	415	415000	jonxhë	74000	7400	422400	certifikatë 06.11.2006
2	Sabri	Qazim	Mekollari	arë	2105	1/31	2200	pronar	290	415	120350	jonxhë	73500	2146	122496	certifikate 04.09.2008
3	Arian	Qazim	Mekollari	arë	2105	1/32	2200	pronar	300	415	124500	jonxhë	73500	2220	126720	certifikatë 04.09.2008
4	Rexhep	Shaban	Sula	arë	2105	1/15	7373	pronar	300	415	124500	jonxhë	74000	2220	126720	pa certifikatë
5	Rexhep	Shaban	Sula			1/15			45			serrë	17000	76.5	76.5	pa certifikatë
6	Rexhep	Shaban	Sula			1/15						serrë për ndërtim		11250	11250	pa certifikatë
7	Rexhep	Shaban	Sula	arë	2105	1/18.	7373	pronar	270	415	112050	fiq 16shegë,3pjeshkë,3mollë,5ftonj,10,kumbulla, 16 qershii,1hardhi,10ullinj, 15, totali 367340 lekë	74000	1998	114048	pa certifikatë
8	Rexhep	Shaban	Sula	arë	2105	1/18.	4437	pronar						367340	367340	pa certifikatë
9	Ali	Shaban	Sula	arë	2105	1/19.	1565	pronar	180	415	74700	asëll	73000	1332	76032	certifikatë 23.11.2007
10	Ali	Shaban	Sula	arë	2105	9/1	2650	pronar	130	415	53950	asëll	73000	962	54912	pa certifikatë
	kanal					686		shtet	20							
12	Xhemal	Ymer	Sula	arë	2105	976/6	1343	pretendues	220	415	91300	rrugë			91300	pa certifikatë
13	Shkelqim	Osman	Sula	arë	2105	976/10	1440	pretendues	90	415	37350	rrugë			37350	pa certifikatë
14	Hajdar	Ymer	Sula	arë	2105	976/11	2900	pretendues	140	415	58100	rrugë			58100	certifikatë 21.01.2007
15	Ramazan	Hamza	Sula	arë	2105	976/13	4240	pretendues	185	415	76775	rrugë			76775	pa certifikatë
16	Bashkim	Hamza	Sula	arë	2105	976/14/1	16000	pronar (b.p)	800	415	332000	rrugë			332000	certifikatë 20.07.2007
17	Jakup	Ramazan	Murataj	arë		976/18/1	4650	pretendues	270	415	112050	rrugë			112050	pa certifikatë
18	Mustafa	Ramazan	Murataj	arë	2105	976/18/2	3675	pronar	200	415	83000	jonxhë	74000	1480	84480	certifikate 09.01.2008
19	Musa	Ramazan	Murataj	arë	2105	976/18/5	4200	pronar	180	415	74700	jonxhë	73500	1332	76032	certifikatë 09.01.2008
20	Muhamet	Ramazan	Murataj	arë	2105	976/18/6	3910	pronar	160	415	66400	misër	73500	1184	67584	certifikatë 12.12.2008
21	Musa	Ramazan	Murataj	arë	2105	976/18/7	3910	pronar	240	415	99600	misër	73500	1776	101376	certifikatë 12.12.2008
22	Lulzim	Pellumb	Beqiri	arë	2105	115/12	2650	pronar	800	415	332000	misër	74000	5920	337920	certifikatë 08.12.2003
23	kanal			arë	2105	440		shtet	50							
24	Rustem	Qerim	Sula	arë	2105	116/2	8800	pretendues	560	415	232400	25 rrënjë, ftonj, shegë, kumbulla			232400	pa certifikatë
25	Rustem	Qerim	Sula		2105	117a		pretendues	260	415	107900	jonxhë	73500	1924	109824	pa certifikatë
26	kanal				2105	427		shtet	45							
27	Rustem	Qerim	Sula	arë	2105	1118/1	7100	pretendues	1800	415	747000	ulli 1 rr, shegë 2 rr, mollë 3 rr,kumb 6 rr, ftua 5 rr, total 21+24		107090	854090	pa certifikatë
								SHUMA	8535		3475625			517651	3993275.5	

VENDIM
Nr.275, datë 6.4.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.956, DATË 24.11.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË SHKODRËS TË PRONËS NR.373 “ISH- GRUP ARTILIERIE ”, NË TEPE, SHKODËR, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES””, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja “c”, 3, 5, 7 dhe 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.956, datë 24.11.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ky ndryshim:
- Në titullin e vendimit dhe në pikat 1 e 2 të tij, fjalët “...Ish-grup artilerie...” të zëvendësohen me fjalët “... Reparti ushtarak nr.1150...”.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.276, datë 6.4.2011

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AZERBAJXHANIT, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.277, datë 6.4.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1497, DATË 19.11.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHTYPJEN E LETRAVE ME VLERË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 2 të vendimit nr.1497, datë 19.11.2008 të Këshillit të Ministrave, shtohen fjalët “... si dhe diplomat e maturës shtetërore.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.279, datë 6.4.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS
HAJMEL TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Hajmel të qarkut të Shkodrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Hajmel të qarkut të Shkodrës, miratuar me vendimin nr.768, datë 24.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Hajmel të qarkut të Shkodrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Hajmel për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
2-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9,10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
11-191 192,194-200,202,203,205, 206,207	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
193,201,204	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave dhe objekteve të çdo lloji	Në përdorim
221-225	Varrezat publike	Në pronësi
226-237	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
238,246,249,253,259,261,265,279	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi

VENDIM
Nr.280, datë 6.4.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE SHITËTËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS TËRBUF TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrative të komunës Tërbuf të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 133 (njëqind e tridhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 926 (nëntëqind e njëzet e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Tërbuf për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
8-13/1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
34,79,91,92,196,226-230,251 - 255,284,297-307,315-323,325-330, 332-346,348-373,378,380,382-387, 389-391,398-403,417-420,423-434, 436,441,444,449,450,453,537-554,649	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
20-24,27-31,555-590,592,598-604, 606-628,633-634	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
32,33,35-78,80-90,93-195,197-225, 231-250,256-283,285-296,308-314, 324,331,347,374-377,379,381,388, 392-397,404-416,421,422,435,437-440,442,443,445-448,451,452,454-536,591,593-597,605,710-718,720-735,913	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore,troje të zëna)	Në pronësi
652-691	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
694-708	Shërbim funeral	Në pronësi
774,775,777,778,780,781,783,784, 786,789,790,791,794,795,796,809, 816,822,837,841,851,880	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive, kanale të treta)	Në pronësi
773,776,779,782,785,787,788,792, 793	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
14-19	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturale e sportive	Në pronësi
736-771	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
881,882	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi

VENDIM
Nr.282, datë 6.4.2011

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 7.12.2010 “PËR ÇËSHTJEN NR.18381/05 “MISHGJONI KUNDËR SHQIPËRISË””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.12.2010, për çështjen nr.18381/05 “Mishgjoni kundër Shqipërisë”, në shumën 3000 (tre mijë) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat, për dëmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave. Afati përfundimtar për kryerjen e ekzekutimit është data 7.6.2011.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

4. Shuma e përcaktuar si detyrim, në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankueses, zj. Mirela Mishgjoni, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

5. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankueses, zj. Mirela Mishgjoni, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.283, datë 6.4.2011

PËR KALIMIN E SIPËRFAQES 2570.5 M², PRONË SHTETËRORE, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË PËR NDJEKJEN E PROCEDURAVE LIGJORE QË NEVOJITEN PËR NDËRTIMIN E XHAMISË “NAMAZGJAJA”, PËR KOMUNITETIN MYSLIMAN SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.1.2011 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Sipërfaqja prej 2570.5 (dymijë e pesëqind e shtatëdhjetë pikë pesë) m², e ndodhur në zonën kadastrale 8150, me numër pasurie 1/82, pjesë e pronës së listuar me nr.592, me sipërfaqe të përgjithshme 6739 (gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë) m², në listën e miratuar me vendimin nr.834, datë 13.12.2006 “Për miratimin e listës së pjesshme (pjesa e parë dhe e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Tiranë të qarkut të Tiranës”, pronë shtetërore, sipas planit të rilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kalon në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim ndjekjen e procedurave ligjore që nevojiten për ndërtimin e xhamisë “Namazgjaja”, për Komunitetin Mysliman Shqiptar.

2. Ndalohej tjetërsimi apo dhënia në përdorim e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, për qëllime të tjera, të ndryshme nga ndërtimi i xhamisë “Namazgjaja” e Tiranës, për Komunitetin Mysliman Shqiptar.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave dhe Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE
(për inventarizimin e pronave të veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
585	8150 P-11	6/160	Truall	Lulishte Partia Socialiste	1866		Shërbime	Bashkia	Nd.nr.1	
586	8150 0-11	6/192	Truall	Lulishte Pjaca	1505		Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	
587	8350 0-11	2/87	Truall	Lulishte Platforma	371		Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	
588	8350 0-11	2/90	Truall	Lulishte pas platformës	1560		Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	
509	8150 P-11	6/162	Truall	Lulishte pas Ministrit së Bujqësisë	6512		Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	
590	8150 P-11,12	1/127	Truall	Lulishte 28 nëntori, Sahati	3091		Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	
591	8150 OP-12	1/29	Truall	Lulishte Ushtri i panjohur	776		Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	
592	8150 PQ-12	1/82	Truall	Lulishte Namazgjaja	6739		Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	

VENDIM
Nr.284, datë 6.4.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-
VJEÇARE “BESËLIDHJA”, BASHKIA LEZHË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i shkollës 9-vjeçare “Besëlidhja”, bashkia Lezhë.
 - Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë Lezhë.
 - Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 873 (tetëqind e shtatëdhjetë e tre) m² tokë truall, e vlerësuar me 20 000 (njëzet mijë) lekë/m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi 17 460 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.
 - Shpenzimet procedurale të përballohen nga bashkia Lezhë.
 - Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 17 460 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
 - Shpronësimi të përfundojë brenda muajit maj 2011.
 - Bashkia Lezhë të bëjë likuidimin e pronarëve, brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 - Bashkia Lezhë, si përfituesi për të cilin kryhet procedura e shpronësimit, të kryejë regjistrimin e pasurive të paluajtshme që shpronësohen pranë Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë.
 - Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bashkia Lezhë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË
SHKOLLËS 9-VJEÇARE PUBLIKE “BESËLIDHJA”, LEZHË

Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. truall m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e tokës (lekë)	Vlera totale e Shpronësimit (lekë)
Adlije Rexhep Hafizi	8632	4/44	72.75	20 000	20 000	1 455 000
Hasan Ramiz Hafizi	8632	4/44	72.75	20 000	20 000	1 455 000
Remzije Kamber Hafizi	8632	4/44 4/25	145.5	20 000	20 000	2 910 000
Arjan Bahri Hafizi	8632	4/44 4/25	145.5	20 000	20 000	2 910 000
Violeta Ramiz Hafizi	8632	4/44	72.75	20 000	20 000	1 455 000
Remzije Isa Hafizi	8632	4/44 4/25	291	20 000	20 000	5 820 000
Genci Ramiz Hafizi	8632	4/44	72.75	20 000	20 000	1 455 000
			873			17 460 000

Vlera totale e këtij shpronësimi është 17 460 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Shënim. Bazuar në vendimin nr.1620, datë 26.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna”.

VENDIM
Nr.285, datë 6.4.2011

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR UNIVERSITETIN “FAN S. NOLI”, NË
KORÇË, TË PRONËS NR.542, ME EMËRTIM “SHTABI I BRIGADËS SË
KËMBËSORISË” KORÇË, E CILA ËSHTË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË
18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për Universitetin “Fan S. Noli” në Korçë, të pronës nr.542, me emërtim “Shtabi i brigadës së këmbësisë” në Korçë, e cila është në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, për ta përdorur për zgjerimin e mjediseve mësimore e studimore dhe për forcimin e punës kërkimore- shkencore të universitetit “Fan S. Noli”, në Korçë.

2. Prona nr.542, me emërtim “Shtabi i brigadës së këmbësisë”, në Korçë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Dorëzimi i kësaj prone të bëhet pas transferimit të Komandës së Mbështetjes Rajonale, në Korçë dhe pas heqjes së materialeve e të pajisjeve të Forcave të Armatosura, të magazinuar në këtë pronë.

4. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, i ndalohej të ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose ta japë në përdorim të tretët.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE (Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

Ministria e Mbrojtjes Bashkia: Korçë Fusha e përdorimit të pronës: Për mbrojtjen										
	A		B				C			
Nr.	Zona kadastrale, indeksi i hartës	Numri i pasurisë	Emërtesa e pronës, vendndodhja/shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/ vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose MI	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me përgjegjësi administrative	Enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
542			Shtabi Brig.K			13023 m ²	Për mbrojtjen	MM Rep.Usht.8800 Tiranë	Rep.Usht. nr.4400 Korçë	
			Lagjia nr.3 Rr.P.Shana Korçë	Zyra te Br.K	Lagjia nr.3 Rr.P.Shana Korçë	1100				2 kate
				Truprojë		132				
				Depo materiali		150				
				Depo		40				
				Garazh auto		250				
				Postbllok		50				
				Depo		12				
				Kabinë elektrike		16				
				Truall		11273				
				Linjë elektrike		300 MI				
				Linjë ujësjellësi		150 MI				
543			Reparti Ushtarak nr.1057			16100 m ²	Për mbrojtjen	MM Rep.Ush.1050 Tiranë	Rep.Usht. nr.1057 Korçë	
			Çardhak, Korçë	Zyrat e komandës	Çardhak, Korçë	324				
				Ndërtesa e motorit		25				
				Ndërtesë cistem.karb.		16				
				Terren sportiv		700				
				Godina e telekomit		60				
				Rrugë të brendshme		100 MI				
				Linjë elektrike		230 MI				
				Truall		14975				
544			Qendra e mobilizimit			1210 m ²	Për mbrojtjen	MM Q.Mobilizimi Korçë	Qendra mobilizim Korçë	
			Rr. "Rinia", Korçë	Zyra	Rr. "Rinia", Korçë	195				2 kate
				Kabinë elektrike		16				
				Tunel		50				
				Tunel		50				
				Tunel		50				
				Depo materiali		100				
				Linjë ujësjellësi		80				
				Linjë elektrike		30				
				Truall		749				

VENDIM
Nr.286, datë 6.4.2011

**PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “HËNA E PLOTË” (BEDËR),
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2, 43, 44, 44/1 dhe 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e shkollës së lartë private “Hëna e plotë” (Bedër), e cila ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla e lartë private “Hëna e plotë” (Bedër) organizohet në dy fakultete:

a) Fakulteti i Shkencave Humane, me programet e studimit, në formën e studimeve me kohë të plotë:

i) Drejtësi (3 vite akademike);

ii) Shkenca komunikimi (3 vite akademike);

iii) Shkenca islame (3 vite akademike),

b) Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, me programin e studimit, në formën e studimit me kohë të plotë:

Gjuhë dhe letërsi turke (3 vite akademike).

3. Shkolla e lartë private “Hëna e plotë” (Bedër) do të ofrojë programe studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale prej 3 (tre) vitesh akademike, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në fushat e mëposhtme:

i) Drejtësi;

ii) Shkenca komunikimi;

iii) Shkenca islame;

iv) Gjuhë dhe letërsi turke.

4. Shkolla e lartë private “Hëna e plotë” (Bedër), Tiranë, fillon veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se 3 (tri) javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

5. Ndryshimet në vendndodhje, staf pedagogjik, plane dhe programe mësimore, forma studimi dhe programe, si dhe të elemente të tjera, të bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë private “Hëna e plotë” (Bedër), Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të vlerësimit dhe akreditimit institucional e të programeve të studimit, si dhe të zbatimit të ligjshmërisë në institucion.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shkolla e lartë private “Hëna e plotë” (Bedër) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.287, datë 14.4.2011

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E FUSHATËS SË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, MË 8 MAJ 2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, t’i shtohet një fond prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh, për financimin e fushatës së subjekteve zgjedhore për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, më 8 maj 2011.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

URDHËR
Nr.4/1, datë 15.4.2011

PËR KRITERET DHE PROCEDUAT E KRYERJES SË RIMBURSIMIT TË PAGESËS PËR PAJISJET FISKALE DHE TAKSIMETRAT E SUBJEKTEVE TË BIZNESIT TË VOGËL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, Ministri i Financave

URDHËRON:

1. Pika 7 e urdhrin nr.4, datë 12.1.2011 “Për kriteret dhe proceduat e kryerjes së rimbursimit të njërive të qeverisjes vendore, të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimetra”, shfuqizohet dhe bëhet:

“Transferimi i fondeve do të kryhet te llogaria buxhetore: Entiteti i Qeverisjes 001”, Ministria 10, njësia shpenzuese 1010001, kapitulli 01, program 01130 (ekzekutimi i pagesave të ndryshme), artikulli 603.3 me emërtimin “Rimbursim për subjektet e biznesit të vogël për vlerën e pajisjeve fiskale”, Kodi i Degës së Thesarit 3535.”.

2. Pika 8 e po këtij urdhri shfuqizohet dhe bëhet:

“Me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për akordimin e fondeve për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, që ka shkuar për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit kryen çeljen sipas pikës 7.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit realizon në sistem kalimin e veprimit në qendër, sipas procedurës së transaksioneve me xhirim të brendshëm (pa lëvizje *cash*), në kategorinë “Xhirime brenda institucionit”, vlerën përkatëse të çdo njësie të qeverisjes vendore në artikullin 7002100 (taksa e biznesit të vogël)”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode

KËRKESË
PËR SHPRONËSIM PUBLIK
Nr.2253, datë 14.4.2011

Mbështetur në ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë privat, që preket nga ndërtimi i shkollës 9-vjeçare publike, fshati Pezë-Helmës, “Ura e Beshirit” (komuna Ndroq), Tiranë ku subjekti kërkues i këtij objekti është komuna Ndroq, Tiranë.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm për procedurat e shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për pronarin sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari që ka emrin në listën emërore bashkëlidhur dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës: adresa, rruga e Durrësit, nr.23 Tiranë.

LISTA E PRONARIT QË DO TË SHPRONËSOHET SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË
SHKOLLËS 9-VJEÇARE, PUBLIKE, FSHATI PEZË-HELMËS “URA E BESHIRIT”, KOMUNA
NDROQ, TIRANË

Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip.truall m²	Çmimi lekë/m²	Vlera e tokës (lekë)	Vlera totale e shpronësimit (lekë)
Bilal Kasem Goga	2953	1/24	1000	676	676 000	676 000

Vlera totale e këtij shpronësimi është 676 000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

KËRKESË
PËR SHPRONËSIM PUBLIK
Nr.1925, datë 18.4.2011

Mbështetur në ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte) që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës-Qafë-Pilloc (loti I).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Për objektin shtëpi banimi për të cilin në kolonën përkatëse është bërë shënimi “i pakonfirmuar”, do të kërkohet konfirmim pranë ZVRPP-së Librazhd. Në bazë të informacionit që

do të jepet nga kjo zyrë do të hartohet dhe lista që do të propozohet për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Për objektin me shënimin “Proces legalizimi”, pronari përkatës do të likuidohet pas përfundimit të procesit të legalizimit dhe të regjistrimit pranë ZVRPP-së Librazhd, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të dorëzojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 6 891 530.5 (gjashtë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë pikë pesë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR
“QUKËS-QAFË-PLLOÇË), LOTI I

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Numri i pasurisë	Objekt, lloji	Shuma totale (lekë)	Shënime
1	Agim	Sali	Leka	3120	443/40	Karabina	957519.7	Proces legalizimi
2	Avni	Sabri	Kocoli	1169	1088/4	Shesh	246244.8	Leje ndërtimi
3	Shaban	Maksut	Gega	1169	1064/3	Shtëpi banimi	2644136	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Hasan	Maksut	Gega	1169	1064/2	Shtëpi banimi	3043630	I pakonfirmuar
		Totali					6891530.5	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 10.5.2011
Doli nga shtypi më 12.5.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 44 lekë